



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:093646

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05808474

P.nr. 166/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorit profesional Muhamet Musliu në çështjen penale kundër të pandehurit I. K. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par. 3.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.203/2024F, të datës 29.05.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 10.06.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i Shtetit Vjosa Bytyqi, e dëmtuara M. K. dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. F. H., në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli ndërsa me datë 11.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

I. K., nga i ati Z. dhe nëna R., e gjinisë B., i lindur më ..., në P., me vendbanim në fshatin G., komunë e P., ka të kryer katër vjet të shkollës fillore, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike (rast social), me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Me datë 16.02.2024, rreth orës 01:40 minuta, në fshatin G., komunë e P., saktësisht në banesën e tyre të përbashkët, i pandehuri në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-185 për Parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, me qëllim e ka sulmuar fizikisht viktimën e ndjeshme-bashkëshorten e tij M. K., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje fillimisht verbale nën dyshimin se e dëmtuara po e tradhton, si dhe rreth pastrimit të shtëpisë ku fillimisht kishte kërkuar nga e dëmtuara ti pastrojë enët dhe ta pastrojë shtëpinë, dhe në atë moment e sulmon fizikisht të dëmtuarën duke e goditur me rrip-send që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë për shëndetin, e godet në dorë e djathtë, me të cilin veprim të dëmtuarës i ka shkaktuar dhimbje fizike dhe lëndime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshëm për shëndetin përcaktuar nga Ekspertiza mjeko-ligjore e datës 22.04.2024,

-me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 69, 70 dhe nenit 185 të KPRK, si dhe në bazë të 242, 364, 365, 367, 452 dhe 462 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

I. ME DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. I pandehuri, lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, për arsye se është e gjendjes së dobët ekonomike dhe se, pagesa e tyre do t'a rrezikonte gjendjen materiale të tij ose të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.

IV. E dëmtuara M. K. nga fshati G.- Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.203/2024F, të datës 29.05.2024, kundër të pandehurit I. K. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par. 3.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt.10.06.2024, në të cilën prezantuan Prokurori e Shtetit Vjosa Bytyqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, e dëmtuara M. K. dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. F. H..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari deklaroi: E pranoj fajësinë, është e vërtetë si në aktakuzë, ky rast nuk ka me u përsërit më asnjëherë, e lus gjykatën që të më fali kësaj here, unë kujdesem për tre fëmijët, edhe nëse e shoh shtëpin duke u kallur unë nuk do të marr më asnjë veprim ndaj bashkëshortes sime.

Mbrojtësi i të pandehurit av. F. H. lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij deklaroi: klienti im pas konsultimit të mjaftueshëm me mua dhe shqyrtimit të aktakuzës dhe provave të cilat e mbështesin aktakuzën, kemi ardhur në përfundim se i njëjti të pranoj veprën pasi që ndihet fajtor për veprën që e ka kryer, pa dëshirën e tij por nga presioni psikik që ka pasur ditën kritike, si dhe nga kushtet e rënda ekonomike pasi që është rast social. Nga unë ka kërkuar disa herë që të kërkoj nga gjykata që të i ndërpritet masa e paraburgimit për shkak se familja e tij është në gjendje të rëndë ekonomike, bashkëshortja e tij nuk punon sepse kujdeset për fëmijët të cilët janë të mitur. I pandehuri I. K. i mbushi 45 ditë në paraburgim dhe familja e tij është në gjendje të rëndë ekonomike pa prezencën e tij në familje.

E dëmtuara M. K. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë, edhe kësaj here ia fali dhe nuk kërkoj kompensim dëmi, të kthehet në shtëpi dhe të mos bëjë probleme tjera.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga i pandehuri dhe bazuar në shkresat e lëndës. Pasi pranimi i fajësisë është në përputhje me dispozitat ligjore dhe ka bazë edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë. Sa i përket rrethanave rënduese gjykata të ket parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, motivet e kryerjes së veprës penale ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të kësaj aktakuze, si dhe rrethanë tjetër rënduese është kryerja e veprës penale brenda ambientit familjar, po ashtu gjykata si rrethanë rënduese të ket edhe faktin se i njëjti gjendet në paraburgim edhe për një vepër tjetër penale, e që ne si prokurori konsiderojmë se ka të kaluar kriminale, prandaj kërkoj nga gjykata që të i shqiptoi një dënim me burg efektiv, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.2 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par. 3.2 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprat penale e cila i vihet në barrë, premtion se më nuk do të përsëriten veprime të tilla, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese gjykata mori parasysh faktin se vepra është kryer brenda rrethit familjar, si dhe faktin se i pandehuri ka të kaluar kriminale, ka qenë i gjykuar sipas aktgjykimit P.nr.57/2021 i datës 19.07.2021, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 pika 1.4 lidhur me par. 3 të KPRK-së, vepër kjo e kryer ndaj bashkëshortes së tij, me ç'rast është shpallur fajtor dhe dënuar me dënim me kusht, gjithashtu i njëjti është gjykuar dhe shpallur fajtor për shkak të veprës penale Dhuna në familje nga neni 248 të KPRK-së, sipas aktgjykimit P.nr.130/20, i dt. 08.08.2022, është gjykuar me dënim me kusht edhe në këtë rast e dëmtuar ka qenë bashkëshortja e tij tani e dëmtuar, ndaj ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në

dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi lirimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr. 166/24 dt. 11.06.2024

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.